

INTERVISTË ME MELIHATE (MELI) QENËN

Prishtinë | Data: 30 tetor, 2017

Kohëzgjatja: 41 minuta

Të pranishëm:

- Melihate (Meli) Qena (E intervistuar)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Melihate (Meli) Qena: Unë rrjedhi nga një familje punëtorësh. Babën unë e kom pasë furrëtar, bukëpjekës. Ai është me prejardhje nga Hasi. Hasjonët dihen që janë nëpër krejt ish Jugosllavinë, dhe gjithka ka punojnë ata janë kryesisht furrëtarë. Kështu që baba i ka bo simitat ma t'mirë, bukët ma t'mira, kiflet ma t'mira. Dhe gjithmonë kem pasë bukë të nxehta n'shpi. Kryesisht jemi majtë me bukë edhe me turshi.

Jem nontë fmi. Kemi qenë nontë fmi. Tash vllazënit ma s'i kam. Me siguri, vllau i madh ka shku është marrë me art. Ka qenë aktor, regjisor. Ai e ka kry shkollën e filmit në Beograd. Edhe sigurisht në familjet e mëdhaja zakonisht ndodhë që ka t'shkon i madhi edhe këta tjerët orientohen. S'di, ndoshta njifarë instinkti ose njifarë, sdi çka me qujtë atë.... Ndoshta t'u mos ditë çka me zgjedhë, e sheh t'madhin edhe shkon mas t'madhit. Kështu që kryesisht gati krejt familja jemi marrë me art. S'është kjo njifarë privilegji i madh. Kjo është ndoshta ma tepër njifarë fatkeqësie n'shoqninë tonë, m'u marrë një shpi me art sepse n'asnji periudhë arti nuk ka qenë as i vlerësumë, as i... aq sa duhet.

Kështu që gati krejt familja jemi bo pre e një, një pune që nuk sjellë shume dobi. Vllaun... thashë Muharremi që ka qenë regjisor edhe aktor. Mandej Xhevati ka qenë aktor. Vllau i tretë, Nehati, ai ka qenë redaktor i kulturës, në "Rilindje" ka punu. Dhe vllau im ma i vogël, Agim Qena, ai për tridhjetë vjet e ka mbajtur stripin "Tafë Kusuri". Dhe njerëzit, pra po ju flas simbas fjalëve, po ju them atë çka njerëzit kanë thanë, gjithmonë e kanë kqyrë "Tafë Kusurin" edhe kanë pulsën e shoqërisë. Kah po shkon shoqëria, çka po ndodhë sepse ai me pak fjalë, e ka pasë atë aftësi që me i thanë krejt ato çka ndodhin. Unë mendoj që karikatura osht' një jashtëzakonisht profesion i vështirë. Dhe ai edhe ka shku i pari, ka shku shumë i ri, pa i mbush pesëdhjetë vjet.

Edhe pesë motra jemi. Motrat janë mësuse, profesoresha të anglishtës edhe unë jom, që jom marrë me.... Aktrimin e kom kry në Beograd. E mandej masi që jom kthy në teatër, e kom pasë ni mosmarrëveshje me teatër, sepse një gjeneratë e tanë ka qenë e moshës time, qashtu aktore. Kështu që m'thanë, "S'kemi nevojë për ty". Po thashë, "Bursën ma keni dhanë katër vjet". "Mirë, s'është me randësi bursi..." Kështu që mos me zgjatë, asnjë ditë s'kom punu në teatër. Unë kom punu në televizion prej formimit këtu të televizionit. Në të vërtetë televizioni ka pasë edhe përpara, para '74-shit e ka pasë një emision në Beograd në gjuhën shiqpe. Mirëpo, në vitin 1974 ka kalu me krejt programin në Prishtinë. Dhe është formu televizioni i Prishtinës.

Dhe mu më çuditë mas luftës që njerëzit kanë pranë me i fillu krejt prej fillimit. Mos me i marrë mo ata njerëz që kanë qenë në punë, dhe marrë krejt një, një staf të ri... Që është gabim i madh për mendimin tim. Dhe m' duket që nuk e gjenë te asnjë popull tjetër shembull si te na, që nuk rujmë atë që ka qenë përpara nesh, edhe që mendojmë që gjithçka fillon prej nesh. Unë këtë po ju them vetëm si ilustrim, në Beograd e kom pasë një, kështu shkallëve, përballë shkallëve një fotografi të një aktore, e cila ka qenë një amatore, as aktore s'ka qenë. Edhe që kom qenë e detyrume me msu kah ka... n'cilat kafe ajo ka performu, se në të vërtetë atëhere s'kanë pasë teatër.

Mirëpo ata prej qaty, qatyne paraqitjeve t'para ata thojnë që e kanë teatrin prej viti 1800. Pra une mendoj që ne jem i vetmi popull që e fshijmë. Hajde kuptoj, ka diçka n'shoqninë tonë, ndoshta njëfarë kompleksi i grave. Gratë kanë qejf me i mshefë vjet, edhe na po get i mshefim vjet edhe dojmë gjithmonë me qenë t'ri (buzëqeshë) edhe me profesion edhe me punë. Qe nuk osht' farë, diçka për m'u lavdu. Osht' një e metë e madhe mendoj. Edhe në televizion kom punu kryesisht në emisionet për fëmijë edhe emisionet shkollore.

Aurela Kadriu: Zonja Meli, para se me dalë aty. Ndoshta pak ma shumë detaje rreth hapësirës, ambientit ku ju jeni rritë, si fëmijë.

Melihate (Meli) Qena: Okej.

Aurela Kadriu: Çka mbani n'mend, çfarë kujtime?

Melihate (Meli) Qena: Unë... Fëminija e gjeneratës time, prej ktyne fëmijëve tash ndryshon shumë, dallon shumë. Sepse te na, ndoshta krejt ka qenë imagjinata. Na kemi lujtë me do cukla, me do shtaga me do... E s'kem pasë shumë elemente me t'cilat kemi lujtë. Mirëpo ajo ka qenë ma tepër, krejt ajo lojë osht' bo në, në kokën tonë, në imagjinatën tonë, dhe... kurse tash fëmijëve nuk ju lihet kurgjo imagjinata. Unë nuk di çka kanë me imagjinu mo, çka? I kanë lodrat t'përkryme edhe mendoj që prandej bohet një lodër monotone. E sheh fëmiu një lodër ia blen, osht' e shtrejtë lodra, mas pesë minutave mërëzitet me atë sepse për me qenë diçka e frytshme duhet njeriu me pasë n'veti, me t'interesu vet. Me zhvillu imagjinatën, me zhvillu... vetëm atëhere mendoj që osht' një punë e frytshme. Në qoftë se krejt t'jepem të gatshme atëhere kjo i përngjanë ktyne hamburgerave t'shpejtë që janë krejt t'gatshme, duhesh vetëm me i gëlltitë. Që dallon ndoshta prej një, një ushqimi që ti vetë e pregaditë ngadalë, simbas dëshirës, qejfit edhe e shijon ndryshe.

Pra fëminija jonë s'ka qenë e begatshme me lodra po ka qenë ndoshta, e ka pasë një kualitet tjetër. E ka pasë imagjinatën, e ka pasë socializimin ma t'madh, shoqninë e ke pasë ma t'madhe, shokët e shoqet gjithmonë kem qenë bashkë. Tash po m' duket që njeriu osht' shumë i vetmumë prej fëminisë. Pa marrë parasysh që i çojnë fëmitë nëpër çerdhe edhe dojnë me i socializu para se m'u msu madje fëmiu me, me nanën edhe me babën. Unë nuk di a i njëf mirë nanën e babën edhe i çojnë n'çerdhe. Nganjherë me nevojë, nganjherë pa nevojë. Njof shumë prindër që jonë nanat n'shpi edhe megjithatë e çojnë fëminë në çerdhe. Pse? M'u socializu.

Unë nuk kuptoj si mund të socializohet fëmiju me dikënd tjetër, të hujë, pa të njoftë ty. Prandej mendoj që kjo e përcjellë fëmiun në jetën e tij të më vonshme. E përcjellë vetmia, e përcjellë njëfarë droje me u lidhë me njerëzit sepse fëmitë sa do që mendojmë na që shoqërohen ka temperamente të

ndryshme, ka tipe të ndryshme. Disa shoqërohen, disa nuk shoqërohen edhe ata më të ndishmit zakonisht pësojnë në ksi rrethe t'mëdha, të ashtuquajtura socializimi. E në të vërtetë ka shumë njerëz e shumë jonë vetëm.

E pra fëmijënisë time ajo nuk iu ka kanosë normal, se kem qenë, i kem zgjedhë dy-tre vetë, katër-pesë vetë me t'cilët ke mujtë me nda dhembjen, gëzimin, idhnimin, krejt. Sa m'përket mu, unë gati gjithmonë kom qenë vetëm. Unë kom pasë dëshirë me, me qenë vetëm edhe në një kand sepse po them, jom rritë në një shpi ku ka shumë fëmijë. Mirëpo unë gjithmonë e kom zgjedhë një kand ku kom lujtë me lodra t'mija, me do kuklla që i kom punu vet. Edhe e di që shumë gjatë kom lujtë me kukulla. Ndoshta ajo ka qenë njëfarë predispozite ndoshta, njëfarë fati që m'ka përcjellë ma vonë, ose njëfarë parandjenjë që kom m'u marrë me kukulla, m'falni (kollitet).

Kështu që krejt jeta, edhe shkollë edhe fëmijënisë mendoj që kem qenë ma t'lidhun, ma bashkë, ma... Në shkollat tona ka pasë klube të ndryshme, ka pasë shoqata të ndryshme, të cilët jonë marrë me, secili simbas afinitetit të vet, fëmijët jonë marrë... dhe vazhdimisht kemi qenë nën mbikqyrjen e arsimtarit, mësuesit. Kështu që e kem pasë njëfarë kujdesi. Krejt e mira dhe e keqja që kanë ndodhë, kanë ndodhë mrenda në shkollë. S'ka pasë atëhere kështu kafiqa kaq shumë. Edhe mendoj që s'ka qenë njëfarë e mete e madhe. E krejt jeta ka qenë pak ma e organziume. Për çdo të shtune ka pasë mbramje letrare që na kemi shku nëpër klasa, nëpër salla të fizkulturës i kem dëgju poetët. Tash nuk di a shkon dikush, a ndëgjojnë poezi këta fëmijë?

Unë disa nipa që i kom në shpi, ata nuk e dijnë asnjë poezi. Unë nuk di a s'msojnë në shkollë, s'ju thojnë me msu sigurisht. Sepse është një program i ri i cili ndoshta nuk e sheh të arsyeshme mësimin e poezive ose nuk e di. Unë mendoj që bota në qoftë se mirret veç me landë natyrore kështu dhe pak mirret me poezi, me art m'duket që është shumë e vrazhdë. Edhe në këtë vrazhdësi gati është e pamundur me jetu njeriu. Sepse arti e frymëzon njeriun, e fisnikëron, e bon ma bujar, ma skofiar. Kështu që krejt t'mirat e një jete suptile, të ndishme vijnë prej artit. Se njeriu nuk është vetëm trup, është edhe shpirt. Dhe ajo brendësi e njeriut duhet të zhvillohet. I ka disa fibra, disa pejëza shumë ma t'holla, ma t'ndishme cilat mund të zhvillohen vetëm me art.

Aurela Kadriu: Zonja Meli, a ju kujtohet qysh ka qenë për juve me u rritë në familje artistësh? A mundesh me na folë pak për këtë pjesë?

Melihate (Meli) Qena: Po, unë vllazënit krejt jetën time gati, shumë pak i kom pa se ata kanë jetu në Prishtinë, e na kemi jetu në Mitrovicë. Kështu që ata vetëm kur kanë ardhë kohë mbas kohe, ajo ka qenë një festë sepse vllau i madh i imi ka këndu shumë bukur. Edhe ka marrë kitarën edhe rreth tij jemi mbledhë të gjithë edhe kemi këndu. Edhe baba e ka dashtë shumë kangën edhe për çdo mbramje gati na ka mbledhë neve fëmijët... edhe kemi qenë një kor i vogël ashtu. Prej atij kori unë gati gjithmonë e kom prishë atë kor, se s'kom këndu bash mirë. Po s'e kom lshu zanin qaq shumë sa m'u dallu edhe kom qenë diqysh ma si n'hije.

Po gjithmonë ka qenë familje e hareshme. Edhe qato qe e kemi pasë, s'kemi pasë shumë, po e kemi nda bashkë. Edhe nuk ka ndodhë për shembull kurrë te na m'u ulë, n'sofër na atëhere kemi hongër bukë... m'u ulë n'sofër edhe mos me pytë, "A m'takon qikjo mu?" Sepse aty shume vetë kemi qenë, edhe secili e ka pasë pjesën e vet. Kështu që s'kem pasë shumë po ka pasë njëfarë solidariteti. Edhe ai

solidaritet mu m'ka përcjellë gjithmonë n'jetë. E une s'di për këtë pjesë është ndoshta ma mirë me folë dikush tjetër, që më ngef. Sepse as s'kom dëshirë me hangër diçka vet, as me pi diçka vet, s'më pihet. Këtë pjesë të jetës kom dëshirë me nda, krejt pjesët e mira kom dëshirë me i nda me të tjerët, pos pjesës kur punoj që kom dëshirë me qenë vetëm. Dhe atëherë me t'vërtetë më pengojnë të gjithë.

Kështu që jeta në familje me shumë fëmijë ka qenë interesante. Mirëpo na s'kemi pasë, kemi qenë ndoshta shumë të vobektë n'atë kohë.... Megjithëse, krejt shoqnia ka qenë e tillë po na ndoshta jemi dallu pak n'këtë aspekt sepse shumë fëmijë kemi qenë n'shpi edhe shpesh është dashtë m'i pritë këpucat e motrës deri sa t'kthehet ajo prej shkollës ose palltën me veshë. Njihere m'ka nodhë në orë të mësimi, se orët e fiskulturës s'kem pasë sallë, edhe i bojshim, dilshim n'oborr. Edhe ish pranvera, dulëm n'oborr na, luftëm disa lojna me top, e s'di çka. Edhe unë e kom harru palltën, pemë ka pasë n'oborr të shkollës. E kom harru me një pemë palltën. Edhe kur kemi hy në orë të mësimi m'u ka kujtu pallta. Edhe pa e vetë arsimatin fare, veç ngajta edhe dola, e gjeta palltën. Erdha n'klasë arsimtari po thotë, “Çka u bo? Çka t'gjet?” Thashë, “Po, e kom harru palltën në një pemë e shkova me marrë”. Tha “Eii, a qat' palltë që osht' historike, gjeneratë mas gjenerate p'e bani qat' palltë”. Thashë, “Mu për qato që osht' historike e rujmë me kujdes”. Normal që u preka shumë prej atyne fjalëve po s'dashta me bo dramë aty para fëmijëve, edhe thashë, “Prandej se osht' historike p'e ruj shumë me kujdes”. Kështu që edhe arsimtari, meqë i kemi pasë arsimtarët e njejtë gjeneratë mas gjenerate, e ka mbajtë n'mend palltën që me të njejtën palltë po rritëm, katër-pesë gjenerata.

Pak ka randësi, ka randësi për një moment ndoshta po ajo që është shumë e randësishme është pasuria shpirtërore, ajo që bartë në shpirt, që ki n'veti. Sepse përpara kanë qenë edhe shoqatat e Kryqit të Kuq edhe nëse s'ke pasë diçka me veshë, këpucë ose xhemper, ose diçka ke shku. Na i kemi pasë për shembull në rrugën tonë ka qenë një njeri që... secila rrugë e ka pasë nga një depo që ka shku edhe i ka marrë gjanat që i duhen. Edhe na shkojshim shpesh merrshim aty, për m'u veshë gjana, garderobë. Edhe tash unë dallohesha prej të tjerëve sepse isha gati gjithmonë ma s'mirti e veshun. Po e veshun me tesha të Kryqit të Kuq. Edhe po sa shkojsa n'klasë i nijsha pëshpërima, (pëshpëritë) “Kyqi i Kuq, Kryqi i Kuq...” Edhe mu m'vijke keq sepse thojsha, “O Zot nuk e kom një fustan t'thjeshtë si tjerët, mos m'u dallu prej tjerëve”.

Kështu që dashtë e pa dashtë rrethanat kanë qenë të tilla që jom dallu prej rrethit, edhe jo për diçka kumeditë çka t'mirë. Megjithatë s'kom qenë si të tjerët. Dhe kjo ndoshta ka ndiku, ka ndiku edhe ma shumë me u zvetnu, me qenë vet, me qenë me botën time. Ndoshta me pasë qenë rrethanat tjera as nuk isha marrë me këtë punë, nuk e di...

Aurela Kadriu: Ku e keni kry shkollën, ku e keni kry shkollën fillore?

Melihate (Meli) Qena: Shkollën fillore e kom kry në Mitrovicë, edhe t'mesmën.

Aurela Kadriu: Në cilat shkolla?

Melihate (Meli) Qena: Në shkollën, atëherë ka qenë një shkollë “Svetozar Markoviq”, shkolla “Muharrem Bekteshi”. Mandej ka qenë gjimnazi, unë gjimnazin e kom kry në Mitrovicë. Dhe mandej e kom regjistru rusishten sepse në atë kohë nuk ke mujtë bash me zgjedhë çka po don me studiu, por për çka t'jepin bursë. E bursë jepshin për biologji edhe edhe për rusisht, edhe për anglisht. Motra e

zgjedhi anglishtën, unë e morra rusishten edhe... edhe biologjia m'ka pëlqy shumë, kom mujtë me marrë edhe biologji. Mirëpo sa ia fillova me studiu këtu në Prishtinë rusishtën u hapë një klasë, dulë konkursi në '67-shin, në 1967. U hapë një konkurs për një klasë shqiptarësh që do të duhej të shkolloheshin për aktim. Unë konkurova dhe u pranova. Mandej e kryva aktrimin edhe paralelisht e kom studiu edhe rusishtën. Kështu që... s'kom diplomu kurrë po jom absolvente e rusishtës, e di mirë gjuhën, flas mirë edhe përkthej prej rusishtës, kohë mbas kohe.

Aurela Kadriu: A na flisni pak për këtë periudhën e shkollës t'mesme? Qysh ka qenë për juve, qysh e kujtoni?

Melihate (Meli) Qena: Po shkolla, krejt ai argëtimi që ka qenë n'atë kohë, mlidheshim në salla të fizkulturës t'shtuneve bojshim ballo, vallëzim. Edhe unë shumë rrallë kom shku. Njiherë shkova me motrën edhe vetëm e kom pa një sallë t'madhe edhe karrigat kanë qenë kështu rreth e rreth, e mesi ka qenë i lirë për vallëzim. Edhe vijke dikush t'zgjedhke me vallëzu. Unë pritsha, pritsha që po m'zgjedhë dikush, mu nuk m'zgjedhi kërkush. Edhe gati ish koha me shku po vjen një djalë, ai ja nisi rend mi thirrë çikat me vallëzu, njëna, e dyta, e treta, e katërta... s'pranunë m'u çu me vallëzu. Edhe ma n'fund, kur erdh te unë me siguri ju bo bajat edhe atij, nuk m'thirri mu hiç edhe u ul, kaloi. Kështu që e pashë që s'kom bash fat shumë me ballo edhe mo nuk kom shku. Megjithëse, ai ka qenë argëtimi i vetëm që kanë shku vajzat atëherë. Ka qenë *Rock and Rolli*, unë i kom ditë krejt lojna me lujtë. Ma shumë kom ushtru vet se sa që kom shku nëpër ballo.

Kështu që i vetmi argëtim ka qenë që... Edhe, po them, ka qenë grupi dramatik ku na kemi përgaditë drama, kemi përgaditë program për shkollë. E aty kom qenë gjithmonë, kom marrë pjesë edhe kom qenë një ndër recitueset më t'mira. Unë mendoj që dij me i thanë vargjet ma mirë se sa që dij me aktru. Sepse poezia m'pëlqen shumë edhe e boj atë punë me dëshirë, me vullnet. Dhe krejt çka bohet me dëshirë duhet t'ketë sukses, sigurisht.

Aurela Kadriu: Qysh ka, a na tregon qysh ka ardhë deri te fakti që keni vendosë me shku në Beograd? Qysh kanë qenë rethanat?

Melihate (Meli) Qena: Po ka qenë një konkurs i hapun këtu në Prishtinë, sepse dëshirojshin me shkollu një gjeneratë aktorësh. Sepse këtu ka qenë vetëm Shkolla e Lartë Pedagogjike, s'ka pasë fakultet për aktrim. E, me siguri kanë mendu që me ardhë profesorët prej atje, prej Beogradit ka kushtu shumë shtrejtë, kështu e kanë çu një grup t'rinjësh, n'mesin e tyne kom qenë edhe unë. Kanë qenë edhe dy vajza tjera, njena ka qenë e Pejës, shumë e bukur, shumë e talentume edhe pranunë n'atë rrethin e ngushtë. Sepse ishte audicioni, në qoftëse pranohesh n'rrethin e parë atëherë 15 ditë punon me profesorët atje, edhe vjen edhe provimi i dytë. E në qoftëse pranohesh atëherë vazhdon, në qoftë se jo mundesh m'u rruz edhe mos me vazhdu.

Kanë qenë edhe dy vajza, njena u rruz n'atë rrethin e parë. Njena e Pejës, shumë e bukur, shumë ekstravagante, ajo u pranu. Mirëpo ato 15 ditë që duhej me qenë në Beograd edhe me punu, një ditë ajo po m'thotë, "Meli unë po kthehna në Pejë". "Pse?" Unë e luta mos m'le vetëm se isha tash veç vetëm, edhe shtatë djem në grup. Tha, "Jo duhet me u kthy sepse unë jom e fejume, edhe m'ka thanë i fejumi, 'Ose unë, ose Akademia'". Edhe tashë, "Ti çka zgjedhe?" Tha, "Unë e zgjedha t'fejumin". Unë mendoj se ka bo mirë, s'ka hupë kurgjo. Edhe mo kurrë s'e kom pa atë vajzë. S'jom taku mo kurrë me

të. Veç e di që ka qenë shumë e bukur, m'ka mbetë... S'ja di as emrin, m' duket mbiemrin e ka pasë Bërlajolli nëse s'gaboj. Ka qenë shumë atraktive. E jo si unë e thatë, une dobët, e kështu... s'kom qenë farë për m'u pa diçka. Edhe, "Jo", tha, "unë po shkoj po kthehna në Pejë".

Ajo u kthy, unë meta me shokët e klasës që normal m'ka mungu shumë një... Nejse na mësimet i bojshin gati krejt bashkë me grupin e sërbëve. Po, vetëm aktrimin e bojshim ndamas. Na i mësojshim tekstet në gjuhën shqipe, profesorët e kishin përkthimin. Edhe ka qenë njikohësisht edhe profesor edhe ka studiu vllau im, Muharremi. Kështu që kryesisht punojshim me të. Edhe ai, se unë paraparakishit s'jom konsultu me të fare. Kur m'ka pa në Beograd, "E ti çka po don?" Thashë, "Po qe, unë po studioj". "Au, po pse? Nuk është kjo për ty, ti je e ndishme, kjo është punë e vështirë..." Me siguri t'u më njoftë mu e t'u e ditë sa, sa është punë jashtëzakonisht e vështirë, sa kërkon mund, e sa kërkon ndjesë, e sa kërkon përkushtim ka dashtë ndoshta pak me m'kursy. Po nuk është kjo punë që kursehet dikush.

Shkon njeriu, ndoshta fati, ndoshta shumë shpesh, njeriu mendon diçka tjetër me zgjedhë, e ndodhë diçka tjetër. Kështu që pak... Na mendojmë që mundet njeriu me ndiku n'rrugën e vet. Unë mendoj që diçka lidhet edhe me fatin, nuk është bash krejt që mundesh me, me dirigju vet. Nuk është jeta një simfoni të cilën ti e dirigjon dhe shkon simbas teje. Shpesh ndodhë diçka tjetër që s'ke mendu as... po me siguri e kemi t'caktume rrugën jetësore, fatin n'jetë. Ndoshta kur vijmë n'këtë jetë, vijmë me njëfarë detyre edhe fluiditet, atomet na rregullojnë me shku qanej, sdi.

Aurela Kadriu: A na tregon kujtimet që i mbani n'mend prej kësaj periudhe në Beograd? Gjithçka... sa ma shumë detaje që ju kujtohen prej asaj kohe për neve janë interesant. Prej momentit kur jeni shku, gjithçka...

Melihate (Meli) Qena: Në Beograd kur kom shku s'ka pasë atëherë student shqiptar që s'ka marrë me veti gurabia. Sepse gurabiat qëndrojnë shumë edhe mundet me t'ndodhë gjithçka n'rrugë, mos me pasë me hongër e merr një gurabi. Edhe unë e kom pasë një, një shami t'nanës aty edhe nja katër-pesë gurabia n'kofër. Atëherë valixhet kanë qenë t'kartoni jo... Edhe kemi udhëtu me tren, tetë, shtatë-tetë orë deri në Beograd. Treni ndalej në secilin stacion. Kështu që kur kom m'ri në Beograd ditët e para unë shumë kom qenë e pikëllume, s'kom mujtë me u adaptu hiç. Koferi m'rrike naltë, qaty mbi orman, mendojsha gjithmonë me u kthy, mos me nejtë. Kajsha për natë kur bijsha me flejt. Jasteku im ka qenë krejt i lagur me lotë edhe mendojsha m'u kthy gjithmonë. Në mëngjes kur u çojsha, ka pasë shumë studente gjakovare të cilat kanë studiu degë të ndryshme dhe ato kur m'shifshin, "Po hajt Meli edhe sot, shkon n'msim, mandej kqyrim n'mramje".

Kur u kthejsha në mramje, e kemi pasë një klub, "Përpjekja", në Beograd dhe kohën ma t'madhe unë e kom çu n'qatë klub. Dhe mos t'kish qenë qajo shoqatë, "Përpjekja" ku mblidheshim shqiptarët dhe ku i kishim të gjitha instrumentet, këndojshim dhe televizion ka pasë edhe krejt. Mendoj që s'kisha mujtë me qëndru, isha kthy. Kështu që viti i parë kryesisht ka qenë vit i adaptimit, viti i... ndoshta i pendimit pse kom shku edhe kom qenë vetëm, pa asnjë vajzë.

E kështu që, ma shumë kom mendu qysh m'u kthy, se sa qysh me mbetë. Edhe viti i parë akademik, unë kom qenë shumë e dobët, pa asnjë ushtrim gati, veç sa nuk m'kanë rrëzu. Edhe mandej (buzëqeshë) tek kur e kom marrë veten m'thojshin profesorët, "Na tash po shohim çfarë... E kem pa, e

kem ditë po deri sa s'je hapë..." Sepse arti është një, një punë shumë e çuditshme, shumë e ndërlikime, shumë suptile, shumë duhet mund edhe duhet... sidomos pedagogët duhet me pasë shumë durim deri sa një, një njeri i ri, një aktor t'hapet, të shpalesë krejt ato çka i mbanë n'vete. Sepse kjo s'bahet me, me dhunë s'bahet, duhet ngadalë. Duhet durim me pasë dhe me ia, krejt kushtet me ia ofru studentit, njeriut t'ri, për me mujtë ai me u hapë, mu çelë si një lule. Se ndryshe nuk bon, ndryshe e humb një talent ndoshta.

Shumë pedagogë kom ndëgju që thojnë, "Në qoftëse është talent ai hapet e tregon vetën, në qoftëse nuk është do t'shkon, në qoftëse..." Mirëpo nuk është ashtu, duhet pedagogu me pasë shumë durim. Mendoj edhe n'landët tjera, edhe n'degë tjera. Po n'aktrim sidomos.

Aurela Kadriu: A ka qenë Muharremi në Beograd apo...

Melihate (Meli) Qena: Po, po...

Aurela Kadriu: A na tregon pak për kontaktin e parë...

Melihate (Meli) Qena: Po, po. Po them kontakti i parë kemi pasë orë t'aktrimit edhe kanë qenë improvizimet. Improvizimet... unë dola, tha... masi ma majti një ligjeratë, "Po pse ke ardhë, e qysh ke ardhë, as s'je konsultu as, kjo është punë e vështirë, kjo është..." Nejse, "Hajde ushtrimin çka e ke përgaditë". Une s'kisha përgaditë kurgjo, qatë për qatë m'u kujtu thashë që po nxjerri ujë prej bunarit me një kofe. Edhe unë e lshova kofën, kinse po improvizoj, p'e nxjerri ujin... Ai tha, "Ajo kofja është ma rond". Edhe unë tash u mundova... Tha, "Edhe ma e rond". Edhe po mundohna edhe ma shumë, "Edhe pak ma e rond". Edhe gati m'ra t'fikt mu, tha, "A po e sheh sa është i zorshëm arti? Fillimi, e le mo..." Thashë, "Po une sigurisht që s'kom me mushë kofet kaq shumë sa s'muj me i çu edhe..."

Po mendoj takimi i parë me to, përvoja e parë me to ka qenë shumë e idhët, e vrazhdë. Sepse ai nuk dëshironte me m'ndihmu, ai dëshironte me ma ftofë mu aktrimin dhe hajde ishalla po i mushët mendja e po kthehet në Mitrovicë. Që gati edhe kom qenë m'u kthy, po ndoshta diçka më e madhe, më e fortë më ka tërhekë edhe kom mbetë. Për atë që kom mbetë, s'di, kom mujtë edhe diçka tjetër me punu n'jetë. Me siguri te kisha studiu biologjinë, që shumë m'interesojnë lulet edhe bimët, m'interesojnë. Është një botë n'veti... do të kisha qenë ndoshta ma e lumtun, s'di. Po edhe kjo është, arti është njëfarë zbulimi, njëfarë rritje, njëfarë ngjizje, njëfarë zhvillimi. Prandaj ka gjana t'përbashkëta me, me natyrën, me bimët, me krejt.

Aurela Kadriu: A mundeni me na folë edhe për qat' grupin "Përpjekja"? A na tregoni për ato mbledhi?

Melihate (Meli) Qena: "Përpjekja" ka qenë një shoqatë e studentëve shqiptarë, ku ne mbledheshim për çdo mbramje. Ne e kemi pasë grupin e instrumentistëve, grupin e korit, grupin e recituesve. Dhe unë kom marrë pjesë në, gjithmonë kur ka qenë diçka në lidhje me recitim atëherë m'thirrshin mu. Në atë grup ka qenë Ehat Musa, kitaristi i njoftun. Mandej ka qenë një kohë të gjatë Ukshin Hoti, ai ka qenë atëherë t'u magjistru në Beograd. E njof nga afër atë. Dhe kanë qenë shumë, shumë, shumë intelektual shqipëtar. Ka qenë profesor Cana, i cili ka qenë gjithashtu në studime për pasdiplomike. Pra ka pasë dallime t'mëdhaja n'moshë, prej brucoshëve deri në njerëz t'pjekun që kanë ardhë me

magjistru, e që kanë ardhë më doktoru. Ka qenë një larushi e moshave, e përvojave dhe e njerëzve të ndryshëm që kanë qenë interesant, e lamive të ndryshëm.

Dhe po them aty secili shqiptarë e ka gjetë veten sikur... kjo ka qenë njëfarë strehe e madhe për krejt fillestarët, deri sa jonë mësu me njoftë Beogradin, me njoftë... sepse Beogradi n'atë kohë me të vërtetë ka qenë një, një qytet botëror. Sepse kanë ardhë prej krejt botës me studiu. Mandej ka qenë një BITEF-i, festival i teatrove që mbahet edhe tash, vazhdimisht u mbajtë, edhe gjatë luftës. Dhe aty kem taku, kem pasë rast me taku aktorë të ndryshëm, regjisorë të ndryshëm, me u njoftu për s'afërmi me ta. Në atë kohë ka qenë, xhirohej "Odiseja", Bekim Fehmiu dhe... n'akademi ka qenë edhe Faruk Begolli, i cili ka xhiru disa vjet filma edhe nuk ka pasë të drejtë me diplomu, me marrë diplomën e akademisë në qoftë se nuk i ndjekë mësimet. Ti ke mujtë me qenë aktor edhe pa diplomë, mirëpo ata diplomën nuk ta kanë dhonë n'qoftëse vazhdimisht, rregullisht nuk i ke ndjekë mësimet, s'i ke pasë nënshkrimet.

Kështu që mas një pauze katër-pesë vjeçe që ka lujtë vazhdimisht Begolli n'filma, dhe që ka qenë yll... Kur vinte n'akademi na thojshim, "A është e mundun? Ky po vjen n'akademi, s'paska diplomu e ka lujtë n'aq shumë filma". Kështu që aty kem qenë bashkë edhe në "Prpjekje" edhe n'akademi. Edhe një ditë po shkrun me germa t'mëdhaja n'akademi "Çka do me thanë me qenë i madh? Mysafir Bekim Fehmiu". Edhe po vjen Bekim Fehmiu, i bukur, sharmant, e xhironte atëhere "Odisenë". Krejt Beogradi mbas tij, e këqyrshin, gratë sidomos. Edhe... se klasat në Beograd kanë qenë, secila klasë e ka pasë skenën e vet, një mini-skenë, me perde me krejt, ku na i bojshim ushtrimet edhe ka pasë pjesën tjetër ku uleshin spektatorët, profesorët. Edhe atij n'skenë ia kanë pasë qitë një fotele t'madhe ashtu, si t'mbretërve. E pritëm me duartrokitje, ai e shtyu atë fotele, u ul poshtë n'skenë edhe tha, "Hajde, jom n'dispozicion, çka t'ju intereson studentave me m'pytë".

Tregoi ma s'pari për fillimet, qysh ka qenë në atë audicion, qysh e kanë pranë, qysh se ka pritë atë producentin. Ai është vonë pak edhe ky ka shku me kohë, ka pritë pesë minuta, ai s'ka ardhë, ky ka dalë. Edhe ai thotë, çuditet, "Kush është ai njeri që s'ka pritë? A është e mundun mu, emën i njoftun..." Edhe bash interesohet edhe mandej e fiton rolin. Edhe një ndër elementet ka qenë edhe qaj. Se është karakter edhe është bash qasi çfare i duhet producentit. Dhe e ka marrë rolin kryesor, Odise, të cilin e ka lujtë me Irena Papas, e cila tash ka pranë që është edhe ajo shqiptare me prejardhje shqiptare.

Pjesa e Dytë

Aurela Kadriu: A e keni pasë restin me, me... me qenë se ishit studentë prej Kosovës, a e patët rastin me komuniku për së afërmi në atë rast?

Melihate (Meli) Qena: Po, po. Ai, ai e dinte që jemi një grup shqiptarësh edhe tha, "Po m'vjen shumë mirë që keni ardhë me studiu, këtu keni vërtetë çka me msu". Edhe mandej ai vazhdimisht e ka percjellë punën time. Edhe kur kom diplomu unë, ai ka ardhë m'ka pritë derisa e kom desh kostumin

dhe më ka prezentu te krejt profesorët e regjisorët e ndryshëm që kjo është e Kosovës, një shqiptare që ka diplomu. Dhe ka qenë shumë, shumë i afërt, dhe shumë në njëfarë mënyre na ka mbrojtë neve. E kem pasë njëfarë strehe, njëfarë mbrojtje te ai. Ka qenë kështu në shikim të parë i paprekshëm, disi shumë i lartë, plot autoritet. Kështu që, njeriu vetëm prej pamjes së tij diqysh e ke ndi vetën t'vogël edhe.... Mirëpo, kjo ka qenë veç derisa ka fillu fjalja e parë, biseda, mandej e ke ndi vetën krejt tjetër. Sepse ai e ka pasë aftësinë me të liru, me të... mos me hetu atë dallim. E krejt tjetër ka qenë Begolli i cili ka qenë komunikativ, ka qenë njeri i afërt me të gjithë. Edhe ndoshta sa më i ndishëm që të jetë njeriu e ka njëfarë mburoje, duket i paprekshëm, nuk hapet me të gjithë. Po atherë kur fillon njeri me njoftë është diçka krejt tjetër.

Aurela Kadriu: Atëherë, kohës sa ishit t'u studiu në Beograd, a vishit najherë në Kosovë, në Mitrovicë?

Melihate (Meli) Qena: Jo, a visha, po ma shpesh visha në Mitrovicë se në.... Njëherë m'patë marrë malli qaq shumë për Mitrovicë sa që gjithë natën kom udhtu, kom ardhë në Mitrovicë i kom pa t'mitë, jom taku me nanën, me babën edhe në mëngjes jom kthy për Beograd. Më thojshin, "Pse shkove?" "Shkova me marrë një fletore". "Qysh bre deri në Mitrovicë me marrë fletore?" "Po m'duhej ajo fletore shumë"... Edhe u çuditshin krejt. Normal që e dishin që nuk është çështje fletoresh po... Kaniherë e ndijsha vetën shumë t'vetmume edhe kisha nevojë m'u kthy në Mitrovicë. E kur kthehesha e shihsha që s'jom, po pendohna prapë, edhe prapë u kthehesha në Beograd edhe vazhdojsha. Dhe kjo ka vazhdu qishtu nja dy vjet e para, mandej në vitin e tretë u msova. Po vitin e tretë kur u msova, atëherë i kisha edhe një vjet edhe m'duhet m'u kthy. Kështu që njeriu gjithmonë mendon që vinë ditë ma të mira dhe shpreson që vjen diçka ma e mirë, dhe andrron për diçka. Në të vertetë, si thotë një shkrimtar, "Shumicës së njerzve i shkon jeta si kur t'bjen shi, e pret kohën ma të mirë, njëherë s'jeton, po pres m'u kthjellë koha edhe me dalë".

E mendoj që qëndrimi im në Beograd ka qenë qashtu, njëfarë pritje m'u nalë shiu e me dalë... që është gabim natyrisht, po që ato gabime kanë qenë për mu te pashmangshme, sepse kam qenë vetëm, kam qenë... Shumë m'vjen keq me thanë e para, e dyta, e treta, po vertetë kam qenë e para edhe ma s'ka pasë në Beograd, ma s'ka pasë grupe që janë shkollu, pos ka qenë edhe një grup i regjisorëve, për regjisorë që janë shkollu. Se mandej u hap ktu Fakulteti i Arteve Dramatike, në të cilin unë kam punu nja tre mujë ditë edhe e kom pa që s'jom për pedagoge, bash e mirë, dhe e kom lshu.

Aurela Kadriu: A na tregon qysh kanë qenë për juve kto udhëtime si vajzë në atë kohë, vajzë e vetme ne atë kohë, qysh kanë qenë këto udhëtimet Beograd- Mitrovicë nonstop?

Melihate (Meli) Qena: Unë mund t'ju them që Mitrovica ka qenë në atë kohë shumë, shumë, shumë qytet përparimtar sepse në Trepçë kanë punu njerzit e hujë kryesisht. Kështu që, Mitrovica ka pasë standard, Mitrovica i ka pasë bendet e para të *Rock and Roll*-it, muzikës. Për çdo të shtune e të diele ka pasë muzikë serioze, me fraka kanë qenë të veshun njerzit në hotelin e atëhershëm Jadran, që ke mujtë me ndëgju muzikë me Bethoven, me Chopin, me Vivaldi, me... Pra s'kem qenë larg botës, ka pasë terrene të golfit në Mitrovicë, ka pasë bazene, ka pasë... Jeta ka qenë krejt ndryshe prej qyteteve tjera, perkundër ksaj që tash u rrënu Mitrovica dhe s'i përngjan mo vetëvetes. Atëherë ka qenë me të vertetë një shtresë e njerzve që normal, ata i kanë dashtë standardet e veta dhe i kanë kriju për veti, e nëpërmes tyne edhe na i kem shiju ato krejt. Kështu që, nuk ka pasë farë hendeku t'madh, pos që

normal kur kom shku në qytet të madh m'ka pengu zhurma, m'ka pengu ajo tollovi, m'ka pengu... Ka shku nja ni mujë ditë deri sa jam adaptu, t'ushton krytë, t'doket çka, si tash Prishtina që u bo tollovi, që s'i përngjanë kurçkafit. Edhe normal që kom pasë probleme deri sa jom adaptu n'atë rreth.

Aurela Kadriu: A po na tregon për diplomimin e juj, qysh e kujtoni atë?

Melihate (Meli) Qena: Shfaqja e diplomës ka qenë një tekst i Sartre “Lavirja e denjë për respekt”, ose “Lavirja e respektueshme” tash që është një përkthim tjetër, po që unë mendoj që ma i mirë është ai “Lavirja e denjë për respekt” sepse kjo lavire ka qenë në një kuptim të rrethanave të jetës e jo... Dhe aty ka qenë një rol i femnës që e kom lujtë unë edhe katër role të mashkujve që i kanë lujtë shokët e klasës, dhe shfaqjen e diplomës e kem pasë në Beograd. Kem diplomu, mandej të njejtën shfaqje e kemi dhanë edhe në Prishtinë, në takimet e Joakim Vujiq. atëherë mbaheshin disa takime te teatrove dhe kemi lujtë, natyrisht që kur kam ardhë në Prishtinë, kanë ardhë me një kureshtje ndoshta ma shumë, me pa kush është kjo vajzë që ka diplomu atje. Po kureshtja ka zgjatë qaq pak, sa që ma s'kanë qenë as kureshtar as... Madje ju thashë që as s'kanë qenë të interesumë me m'pranu në teatër. Prej gjithë atij entuziazmi kur kom shku në fillim, krejt ato ideale, ato çka kom ëndrru me mbri mas shkollimit jonë rrënu menjherë, dhe unë kom mbetë pa perspektivë, pa punë.

E nga ana tjetër i kom pasë dy fakultete në atë kohë, rusishtën dhe aktrimin. Dhe një gjysë vjeti kam mbetë në shpi pa punë. Mandej mas gjysëvjetorit, një koleg i imi që kem studiu bashkë rusisht e lshoi Mitrovicën, erdh në Prishtinë me ligjërë dhe tha, “Në qoftë se don ti m'u punësu, me dhanë rusisht?” Edhe thashë, “S'di a m'pranojnë”. Tha “Po hajde, qysh s'të pranojnë, s'kanë profesor të rusishtës”. Shkova unë, konkurova, më pranunë, dhe një gjysë vjeti kam punu si profesoreshë e gjuhës ruse. Ma shumë ka pasë nxanës të nacionalitetit serb, sepse ata msojshin rusisht, pak ka pasë shqiptarë. Dhe mbas atij viti, u hap teatri në Prizren, profesionist. Shkova atje një vjet, po si te na qysh shkojnë punët, jonë të entuziazmunë, dojnë diçka me bo, një vjet, zgjat ajo një vjet edhe mas një vjeti u ftofën. Ishte jetëshkurtë ai teatër. Njisoj si iluzionet e mia që s'kanë zgjatë gjithmonë shumë.

Aurela Kadriu: Na tregoni pak për atë teatër në Prizren.

Melihate (Meli) Qena: Në atë teatër ishin pushimet verore dhe po vjen një kerr një ditë para shtëpisë time atje në Mitrovicë. E kom pasë në qendër shpinë, njifarë shpie e vjetër, me çardak, ato çardakat që jonë as në tokë as në qiell, që janë shumë romantike. Tash e kanë rruu atë shpi. Edhe zbriti dikush prej kerrit, po m'lypin mu, “Hajde”, thashë, “kush osht?” Drejtori i teatrit të Prizrenit, i Shtëpisë të Kulturës. Nejse shkumë me bisedu, tha, “Po mendoj me hapë teatrin profesionist edhe me marrë një grup aktorësh, a kishit ardhë?” “Po”, thashë, “kisha ardhë”. Edhe shkumë nja katër-pesë aktorë, të ri, e disa të Prizrenit, disa të Mitrovicës. Edhe në atë kohë erdh edhe vllau im Muharremi me bashkshorten e tij, Igballën. Edhe ata erdhën n'qat teatër. Mendojshim që do të zgjatë puna në atë teatër, ja nisëm me ambicie të mëdhaja, me përkushtim te madh. Po nuk zgjati shumë. Një vjet, mas një vjeti ata thanë, “A e dini çka, shumë po kushton teatri, s'kem llogari”. Kumeditë pse e kanë hapë edhe pse e kanë mbyllë. As s'kom kuptu pse e kanë hapë, me siguri për me i mbulu disa, disa punë të tyne qe s'i kom kuptu kurrë. Edhe ma tepër si punë lavdrimi që p'e hapim teatrin edhe me hapë teatër është shumë lehtë, po me mbajt është ajo çka është shumë vështirë.

Me mbajt një teatër, me kontinuitet me punu, është punë jashtzakonisht e vështirë, është punë që le qe don përkushtim edhe qe don nerva e qe don durim të madh, po që edhe rrethi shumë vështirë të pranon, edhe shumë... Gjithçka e re që osht', e ki një farë pengese t'madhe prej rrethit, prej... Eh tash duhët me qëndru, një herë bojnë hajgare, s'të marrin seriozisht. Masanej me i bind njerëzit që s'është çështje e qefit, s'është çështje e një hiri po osht' diçka serioze, me punu. Mandej ja nisin me t'kqyrë shtremt, mandej mos me t'ndihmu, me t'pengu. E në qoftë se i qëndron krejt këto, n'fund ose dorëzohen ata ose dorëzohesh ti. Në qoftë se ki forcë, qëndron.

Aurela Kadriu: Cilat kanë qenë shfaqjet që i keni bo në teatër profesionist të Prizrenit?

Melihate (Meli) Qena: Deri sa kam qenë në atë teatër, ne patëm pregaditë dy-tre shfaqje. Unë kom lujtë në dy prej tyre. Ka qenë "Koloneli Shaber" teksti i Balzakut me regji të Muharrem Qenës. Dhe ka qenë një meqë paralelisht punonte edhe drama serbe edhe drama shqiptare, në dramën serbe e pata lujtë një rol të një nane. Ajo ka qenë "Fëmiu i hujë" i Joza Horvat, një shkrimtar i Zagrebit, dhe një regjisor serb, Milutin Jasniq, i cili ka qenë regjisor shumë i mirë. Dhe për një vjet qaq. Mandej u mbyll ai teatër dhe u shpërnda grupi, fatkeqësisht.

Aurela Kadriu: A na tregon për audiencën që keni pasë, domethanë veç koka formu njifarë jete kulturore t'paktën për një vit?

Melihate (Meli) Qena: Po, interesimi ka qenë shumë i madh, edhe ka qenë njëfarë euforie jo vetëm te ne, aktorët, po te krejt njerëzit që ka ardhë një grup i ri, po ndodh diçka në Prizren. Mirëpo, fatkeqësia është që, ajo që te na krejt është si një, një balon kur te fryn edhe e lëshon, edhe atij i del ajri, edhe rrëzohet ai baloni shfrymë, mbetet vetëm një lëvozhgë prej tij, shumë e dhimbshme. Edhe ajo eufori pëlçiti dikun edhe kurgjo. Vazhdojshin me grupe amatore deri tash e kanë teatrin profesionist në Prizren. Unë uroj që të vazhdojnë dhe të mos u ndodhë... ne jse, gjithmonë arti është pak i vlerësuar te ne, sidomos në periudha të ndryshme. Ka silime të mdhaja që s'do të duhej me ndodhë. Unë, te nxamë, gjithmonë shkoj shikoj me andje baletin këtu, dhe i shoh ata njerëz të rinjë të cilët janë plot vullnet, plot elan, plot përkushtim për punën e tyre, me sa vullnet e bojnë, punojnë nga dymbëdhjetë orë në ditë edhe nuk di a kanë me hangër nga një burek dhe një jogurt, e bureku edhe baleti nuk shkojnë bashkë, sepse duhet me pasë kondicion edhe për me lujtë edhe për shëndet të plotë.

Edhe kështu ata njerëz të ri që jonë e që do të duhej me pasë mbështetjen e shoqërisë edhe jo vetëm mbështetjen, edhe mirëqenien edhe krejt, nuk kanë kurgjo. Thjeshtë i marrin si disa lojtarë që për qef të vetin lujnë. Dhe madje nuk vinë as me i pa kta pushtetarët. More qe s'vinë hajde de, s'ju mungon atyre ndoshta, po do duhej të kenë shumë ma tepër kujdes për një gjeneratë të re. Ata njerëz mujnë me shty ashtu deri sa të jenë 20-25 vjeç, në qoftë se mendon me kriju familje, me pasë një shtëpi a një ardhmëri tanën duhesh patjetër ose me lanë atë punë, me u marrë me diçka tjetër ose është e pamundun me ekzist.

Aurela Kadriu: Në cilin vit u mbyll ky teatër në Prizren, në cilin vit?

Melihate (Meli) Qena: '73-shin. '72-shin u hap, '73-shin u mbyll. '74-shin, në fillim të '74-shit unë mandej kom ardhë në televizion, dhe në televizion kom punu vazhdimisht deri në vitin 1986, kur osht'

formu teatri i kukullave, e ku unë jom kyç paralel, kom punu edhe në televizion edhe në teatër. Derisa u mbyll televizioni.

Aurela Kadriu: A na tregon pak për këtë periudhën qysh keni fillu me punu në televizion? Krejt atë kohë...

Melihate (Meli) Qena: Në televizion ka qenë konkursi për regjisor dhe unë shkova, konkurova, dhe m'pranunë meqë nuk kishte atëherë regjisor t'shkollumë. Edhe në fillim meqë në Beograd s'kem mësu kurgjo për televizion, atëhere unë bisedova me disa profesorë atje në Beograd dhe shkova nja tre mujë ditë, e percjella punën në televizion, si punohen emisionet, si, me xhirime, me krejt specifikat e televizionit të cilat unë nuk i kom mësu në akademi, dhe e morra njëfarë njohurie solide. Mandej në televizion gjithnjë t'u punu, t'u studiu, t'u, edhe punë praktike t'u pasë shumë, sepse pa marrë parasysh që kem qenë një kolektiv jo shumë i madh, kem punu shumë atëherë na në Televizionin e Prishtinës. Dhe kështu unë në fillim kam qenë asistente, mandej regjisore, mandej regjisore e kategorisë të parë dhe në fund kam dalë si regjisore e pamvarun që kam pasë të drejtë unë me i zgjedh temat, me i zgjedh krejt çka kom dëshirë me punu. Mirëpo, posa e fitova unë atë epititet, ta quaj ashtu, u mbyll televizioni edhe ma s'kom pasë kohë me ushtru, fatkeqësisht kur mas luftës neve s'na pranun mo asnji prej gjeneratës tonë. Dhe ajo ka mujt me qenë veç në letër, regjisore e pamvarun, jom pamvaru vërtetë prej krejtve edhe kom mujt veç me andrru për diçka, për një punë në televizion.

Aurela Kadriu: A na tregon mandej për punësimin, qysh u hap teatri i kukullave?

Melihate (Meli) Qena: Teatri i kukullave... BVI e kulturës, sekretariati i kulturës atëherë, në atë kohë, një zonjë ka punu aty, Rabije Bajrami, djalin e ka tash kryeredaktor ne Kohën Ditore, Agron Bajramin. Dhe ajo ka pasë aq vizion, dhe ka pasë dëshirë me hap një teatër të kukullave se t'u e marrë parasysh që Kosova ka pasur nevojë gjithmonë për një teatër të kukullave. Ka shumë fëmijë e teatër s'ka pasë kurrë. Atëherë i ka mledh disa njerëz, në mesin e tyre ka qenë edhe një regjisor i njoftun, Ismail Ymeri, me të cilin ka bisedu ajo dhe është formu një grup i njerëzve, Fadil Hysaj, Ismail Ymeri, Musa Ramdani, Anton Çetta, disa profesorë.

Është bo një audicion, i kanë zgjedhë 17 vajza e djem në atë kohë dhe me ta ka punu një profesor i njoftun i Zagrebit, Borislav Mrksiq, i cili ka qenë dramaturg dhe regjisor. Ai e ka mbaru në Pragë regjinë. Ka qenë një erudit, një njeri shumë me diapozon të gjanë dhe dituri të gjanë. Dhe me këtë profesor kanë punu kta të rinjë e të reja. Dhe shfaqja e parë ka qenë "Pylli është i të gjithëve" teksti Shaip Grabovci, dhe ka qenë një shfaqje e kombinume me kukulla dhe me aktorë që ka dalë shumë e mirë edhe që kanë qenë një grup vërtetë njerëzish të talentum. Mirëpo që gradualisht ata njerëz kanë punu, po kanë punu veç... Jonë pagu simbas shfaqjeve dhe e kanë pa që s'ka pasë një perspektivë të sigurtë ky teatër dhe prej 17 vetëve gradualisht kanë shku, kanë shku, kanë shku... Tash jem veç pesë aktorë, katër djem edhe një vajzë që nuk ndodhë kërkund në botën e civilizume që do të duhej ky ansambël me i pas tash 350 vetë, jo pesë vetë.

Po na s'mund të ikim prej kësaj përditshmërie tonë, prej mentalitetit të popullit tanë, prej mendësisë që gjithçka fillojmë me eufori. Mandej ajo mbetet në vullnetin, dëshirën e disa njerëzve fanatik të cilët e rujnë atë me fanatizëm te madh, me përkushtim, me vetësakrificë gati... dhe për të cilën natyrisht që unë e kom punu këtë punë me dëshirë teme, dhe e du, po edhe s'kom kërkun asnjherë as

falemnderim, as famë. Po nuk mund ta them që s'kom qenë shumë shpesh e lëndume me pakujdesjen, e ç'vlerësimin fare të kësaj pune që e bojnë njerëzit që kanë qenë përgjegjës, që është dashtë me përparë këtë teatër, që është dashtë ky teatër me shku përpara, që është dashtë me pasë së paku secili qytet nga një teatër të kukullave. Jo, këtë teatër e kem edhe, edhe për këtë mos m'u interesu fare.

Aurela Kadriu: Për të '90-tat, kur jeni largu prej punës, qysh ka ndodhë?

Melihate (Meli) Qena: Po në vitet e '90-ta ka qenë një kusht ose me pranë me punë nën diktatin e njerëzve që kanë ardhë ktu ta kanë pushtu televizionin ose me lshu krejt. Edhe normal na s'kem pasë zgjedhje tjetër ose duhet me bo çka të thojnë ata në të vërtetë ata njerëz na kanë okupu thjeshtë kanë ardhë e kanë marrë televizionin edhe është dashtë me ju përkul kushteve të tyre. Ashtu s'ka pranë kërkush edhe mirë, kanë thanë, "Nëse doni me nënshkru kapitullimin e Kosovës mundeni me punë në qoftë se jo mundeni me dalë". Na kem dalë krejt edhe kem mbetë pa punë, në rrugë. Këtë teatër që e kem pasë natyrisht që s'kanë pasë rroga aktorët kurgjo, pos une kom qenë vetëm e punësime me rrogë edhe, edhe Valdet Rama si menaxher i teatrit. Këta tjerët kanë punë prej shfaqjes në shfaqje, në qoftë se kemi fitu diçka prej biletave, kështu që ajo punë ka qenë shumë gati punë vullnetare që s'ka mujt dikush seriozisht me u marrë me atë punë, në qoftë se ka mendu me u marrë seriozisht.

Atëherë secili e ka zgjedhë rrugën e vet, ka shku tjetërkah edhe dalë ngadale veç e ki pa që teatri po shkatërrohet. Po, edhe është dashtë një fuqi e Sizifit me qëndru edhe me përballu krejt atë neglizhencë të shoqnisë, edhe të rrethit, edhe të krejt njerëzve që të kanë rrethu. Megjithatë, na kem punë, shikues kem pasë gjithmonë shumë, në fillim jo, po mandej, me kohë. Tash i jepim nga dy shfaqje, të shtuneve, edhe kem edhe shfaqje të organizime vazhdimisht për çerdhe, për shkolla, për... dhe kemi plot teatrin fëmijë që megjithatë është një shpagim i atij mudi, i asaj pune që e kemi bo me vite.

Aurela Kadriu: Deri kur ka punë Dodona? Për paraluftës po flasim, deri kur ka punë?

Melihate (Meli) Qena: Dodona ka punë vazhdimisht. Vazhdimisht ka punë Dodona. Edhe gjatë kohës të luftës ka punë. E vetmja oazë, i vetmi teatër që ka punë. Sepse ka punë, qe... Ka punë si teatër privat i Begollit. Begolli e ka pasë një teatër të regjistruar edhe s'kanë mujtë me ndalu atë teatër. E në kuadër t'qatij teatri edhe na kemi punë. Në të vërtetë teatrin e fëmive ata nuk e kanë ndalu. Kështu që, kemi mujtë me zhvillu aktivitetin tonë edhe ka qenë njëfarë oaze ku kanë mujtë fëmijët me ardhë edhe... Jo t'libër bash, kohë mbas kohe i kanë pengu edhe n'teatër me shku, po kryesisht na s'e kemi ndalë asnjëherë punën edhe kemi punë pa marrë parasyshë a kem pa... Shpesh kemi mendu që ndoshta s'mund ta shfaqim hiç shfaqjen, se i kanë pengu shpesh fëmijët me ardhë. I kanë ndalë në rrugë policia, po ata kanë ardhë nëpër rrugë tjera. Kështu që... megjithatë kemi punë n'kontinuitet. Edhe sivjet e feston teatri tridhjetë vjetorin.

Aurela Kadriu: A keni lujtë ndërkohë n'atë periudhë nëpër filma apo kështu projekte projekte...

Melihate (Meli) Qena: Po, unë kom qenë e angazhime edhe nëpër filma, edhe nëpër shfaqje tjera. Kom lujtë edhe në shfaqje të Teatrit Kombëtar. Në të vërtetë ma shumë kom lujtë tash kah pleqnia se sa kur kom qenë e re. Sepse, ka ndodhë qashtu iu kanë vyjtë aktore t'moshës time dhe m'kanë thirrë. Kom lujtë tash s'fundit nja dy-tre filma i kemi xhiru. Njeni është i Lendita Zeqiraj, tash i fundit. Mandej

kom lujtë edhe një film të motra e vet, Blerta Zeqiraj. Dhe një film e ka ba Arzana Kraja. Si duket unë jom simbas shijës t'regjisorëve më shumë se regjisorët që m'zgjedhin (buzeqeshë). Kom lujtë n'shfaqje të Bekim Lumi disa shfaqje. Kështu që... por me dëshirë unë punoj në teatër të kukullave. Aty e gjej vetën ma shumë, e ndijë vetën ma t'lumtur, ma t'libër kur punoj për fëmijë edhe kur t'punoj në teatër.

Aurela Kadriu: A na tregon periudhën e luftës qysh ka qenë me vazhdu me punu n'atë periudhë?

Melihate (Meli) Qena: Po në periudhën e luftës teatri ka qenë ndoshta njëfarë lloj shtëpie ku na jemi mledhë vazhdimisht, pa marrë parasyshë a kemi pasë prova, a kemi pasë... Shumica e studentëve kur s'kanë pasë ku me flejtë, ktu kanë qenë n'teatër. Pra teatri nuk ka qenë veç një teatër ku luhen shfaqjet, po teatri ka qenë edhe një vend ku jonë mledhë studentat, ku i kanë majtë provimet, ku kanë lujtë... Vazhdimisht jonë majtë edhe shfaqjet. Kështu që ka qenë ndoshta një, një dritë n'atë tunelin e zi. Edhe ka qenë e vetmja, i vetmi dell ku kemi mujtë me marrë frymë lirshëm, ndoshta. Shpesh nën kontrollën e policëve, kanë ardhë na kanë kontrollu po ndoshta pse ka qenë një njeri aq i njoftun si Begolli s'ka pasë shumë presion. Na kanë leju me punu.

Kështu që, mandje ka qenë edhe Petrovci, Enver Petrovci, i cili u kthy prej Beogradit dhe i cili ka qenë drejtor i teatrit një kohë. Ndoshta nën mbulesën e tyne kemi mujtë me punu pak, pak ma t'libër edhe mos me qenë qaq shumë t'kontrollumë.

Aurela Kadriu: Mandej a na tregon qysh ndërroi audienca, a kish ndryshim audience apo jo?

Melihate (Meli) Qena: Në atë kohë skena e mbramjes, Begolli e përgadiste "Jom talent se jo mahi" edhe vazhdimisht mirrej me, me problemet e shoqërisë, me njëfarë mënyre cinike folke për krejt përditshmërinë tonë. Dhe ka pasë jashtëzakonisht shumë shikues. Në teatrin e kukullave ne përpiqeshim me organizu krejt çka i mungonte jetës shkollore, koncerte, maskenball. Jem përpjekë diqysh me mbulu atë zbrazëti që ka ekzistë nëpër shkolla. Kështu që atë kohë teatri nuk ka qenë vetëm teatër. Teatri ka qenë edhe çerdhe, edhe argëtim, edhe mësim, edhe krejt. Dhe unë uroj t'kem pasë sukses n'atë punë.

Megjithatë s'e kemi lanë m'i kaplu njerëzit ajo zyrtësi që ka ekzistë gjithka, n'rrugë, n'shpi. Pak ktu ka qenë njëfarë oaze ku kanë mujtë me ndje vetën ma t'libër, pak ma, me pa një botë tjetër, me jetu pak n'atë përrallën, atë iluzion ndoshta. Sado pak ka qenë një freski për, për ata njerëz.

Aurela Kadriu: E mbas luftës çka keni vazhdu me bo? Tregona diçka qoftë për jetën profesionale, qoftë për jetën personale.

Melihate (Meli) Qena: Unë kom mendu që mbas luftës kemi me i pasë punët shumë mirë e që ka me përparu edhe teatri e që ka me pasë aktorë tjerë. Edhe që fatkeqësisht nuk ka ndodhë. Ka ndodhë që e kanë renovu teatrin, zonja Vlora Dumoshi ka qenë drejtoreshë. Teatri është renovu, por dy aktore të cilat unë i kom kërkë vazhdimisht mas luftës, sepse i kom pasë ato aktore, kanë shku jashtë. Dhe unë kom mbetë vetëm me një aktore. E t'u e marrë parasyshë që teatri i kukullave është teatër specifik që shfaqjet që i lujm na ka tridhjetë vjet... Na e kemi një shfaqje që lunë tridhjetë vjet që osht'

vazhdimisht n’repertor. Sepse gjeneratat e fëmive ndërrohen dhe përrallat jonë t’nejta, ngjarjet jonë t’nejta. Ato interesante jonë për krejt gjeneratat, për krejt fëmitë.

Kështu që nuk muj unë m’i marrë vjet për vjet aktoret edhe me i ndrru sepse as nuk kanë pagesa, as nuk kanë... s’kanë kurgjo të rregulume. Dhe lutjet e mia vazhdimisht edhe me shkrim edhe me gojë m’i marrë dy aktore t’reja nuk jonë plotësu kurrë. Dhe unë ende vazhdoj me qenë me një aktore dhe kohë mbas kohe vijnë studentet apo aktoret që më ndihmojnë. Më shumë është ajo ndihmë se sa një punë që iu paguhet atyne. Dhe kështu, në qoftë se vazhdon normal që s’mundet gjatë me shku, edhe gjatë s’mundet me shku. Sepse krejt shfaqjet në këtë teatër i kom punu veç unë. Ajo jo që ma kanë lonë atë hapësinë, a e dini pse? Se nuk paguhet kjo punë, se kishin ardhë tjerët kishin punu. Hiç nuk m’kishin lonë mu. Po s’paguhet kjo punë, s’paguhet. E ne veç kot e kemi gojën veç, “Fëmitë, fëmitë, ardhmëria jonë...”

Se në të vërtetë shumë pak brengosemi për fëmijë edhe shumë pak... Fëmitë i përmendin vetëm nëpër fushata dhe nëpër... në të vërtetë pak mendojmë për fëmijë. Edhe pak, s’mjafton vetëm prindi, duhet shoqnia, duhet rrethi me investu jo veç me folë për fëmijë. Sepse po t’mendonim për fëmijë, na s’kishim pasë klasa me katërdhjetë fëmijë, me katërdhjetë nxanës. Shkollat i kishim pasë pak ma ndryshe. Teatro kishim pasë n’secilin qytet sepse teatri nuk është vetëm argëtim. Teatri është mësim, teatri është lojë, teatri është zhvillim, teatri është hapje e diapazonit, hapje e horizontit. Dhe ata që mirren vesh n’teatër e dijnë sa është i dobishëm për fëmijë. Ajo është lojë. Nëpërmes lojës t’mson shumë gjana. Pa imponim, pa diktat, pa... Dhe loja e rritë fëmijun, dihet. Po ndoshta, n’qoftë se vazhdon kështu është shumë një prognozë e keqe po shpresoj që vetdijësohen njerëzit.

Aurela Kadriu: Çka ka ndodhë ndërkohë në rrafshin, në jetën e juj personale, çka ka ndodhë ndërkohë?

Melihate (Meli) Qena: Në jetën time personale pos t’kqijave s’ka ndodhë kurgjo e mirë se s’di çka mundet me ndodhë e mirë n’qoftë se krejt rrethi nuk i ndëgjon ha... krejt kërkesat tuja hasin në vesh të shurdhët. Dhe kthehet ajo si eho e je n’mëdyshje, “A thashë more diçka, a s’tthashë a? E veç pe dëgjoj zanin tim”. Po pa marrë parasyshë çka të ndodhë unë normal që nuk e kom ndërmend me, me u ndalë, deri sa t’muj mos me u ndalë. Po, e kom marrë shpërblimin për vepër jetësore dhe që për mu nuk është farë, shumë domethanës. Sepse mendoj që atë shpërblim ma tepër ma kanë dhanë me la ndërgjegjën e vet se sa që kanë mendu n’mu ose n’punën time. Për mu, kisha qenë shumë ma falenderuese me i ndëgju fjalët e mija, me i pranu dy aktore se sa me ma dhanë një shpërblim për vepër jetësore.

Dhe për çdo vjet m’thojnë, “Dojmë me ta dhanë një mirënjohje”. Kom thanë, “Ju lutem, mu mos m’jepni mirënjohje se nuk m’duhen kurgjo”. Po, ka qenë edhe presidentja që m’ka ftu me ma dhanë një mirënjohje edhe unë ju kam falenderu kom thanë, “Asgjë nuk m’nevojitet mirënjohja”. Mirënjohja që m’nevojitet osht’ me m’nihmu me bo punën tem qysh duhet. Jo me m’dhanë letra. Letra kom boll une. Muj edhe unë me ju dhonë mirënjohje... madje muj me i përpilu fjalët ma mirë se ata që i...

Aurela Kadriu: Nëse nuk keni diçka me shtu, veç po ju falenderohem shumë për kohën...

Melihate (Meli) Qena: Po unë mendoj që shumë fola bile.

Aurela Kadriu: Shumë faleminderit

Melihate (Meli) Qena: Me nder qofshit.